



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:153651

Datë: 03.06.2021

Numri i dokumentit: 01846737

P. nr.298/2021

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse – praktikante Besarta Hajzeri, në lëndën penale ndaj të pandehurit: D.S., për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3339/2018, të datës 14.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 18.05.2021 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Stojanka Kasalovic dhe të pandehurit D.S., me datën 20.05.2021 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 03.06.2021 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.S., nga i ati N., e ëma M., e vajzërisë D., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku edhe jeton, punon në ndërtimtari, i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 20.06.2018 rreth orës 22:15 minuta, në Mitrovicë, saktësisht afër palestrës sportive i pandehuri D.S. ,pa autorizim ka poseduar substanca narkotike të dyshuar të llojit marihuanë, ashtu që, derisa është ndaluar nga ana e patrollës së policisë duke drejtuar automjetin e markës “B.” me targa..., gjatë kontrollës, në çantën e dorës i janë gjetur substanca narkotike të llojit Marihuanë, në peshën prej 18.99 gram, të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 75, 76 e 275 të KPRK-se, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

## G J Y K O N

1. Dënim me burg me kusht në kohëzgjatje prej nëntë (9) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Dënim me gjobë në shumë prej 800€ (tetëqind euro) të cilën shumë obligohet të filloj që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I njëjti dënim me gjobë mund ta paguaj në tre (3) këste të barabarta. Pagesën e kështit duhet ta bëjë deri me datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë mund t'i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit, sipas nenit 43 të KPRK-së.
3. Në mbështetje të nenit 275 par.3 të KKPRK-së e lidhur me nenin 282 par.2 nenpar.2.4 të KPP-se, ndaj të pandehurit urdhërohet edhe: Konfiskimi i sendeve dhe atë:
  - a. Substanca narkotike e llojit Marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë 18.99 gram.
  - b. Urdhërohet policia e Kosovës që ta shkatërroj substancën e konfiskuar.
4. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Kërkesë pasurore juridik, nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3339/2018, të datës 14.11.2018, kundër të pandehurit D.S., për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e pranoi fajësinë për këtë vepër penale, e di që kam gabuar, nga ajo kohë nuk jam duke e përdorur më, i premtoj gjykatës së nuk do ta përdori as në të ardhmen, andaj e lus gjykatën të merr parasysh rrethanat lehtësuese, faktin se jam në terapi për shkak të një aksidenti që kam pasur më herët nuk jam mirë me shëndet, ndërsa nga puna që bëj të ardhurat janë shumë të ulta.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se janë pëmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lëndës, pranimi është bërë pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, prandaj i ka propozuar Gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë dhe këtë pranim ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë pëmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit,

mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor me nr.2018-DHTN-537 e datës 03.09.2018; Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, i datës 20.06.2018; Deklarata e të pandehurit e dhënë në polici, e datës 20.06.2018; Procesverbali mbi marrjes në pyetje të dëshmitarit E.S., e datës 22.06.2018; Raporti i ekspertit AKF/2018-.../..., i datës 17.08.2018 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, datë 20.06.2018; Fotoalbumi. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-së. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje, faktin se këto vepra penale janë rritje.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, nga fillimi i procedurës penale, faktin se kjo është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin ngase nuk ka të dhëna për vepra tjera penale, faktin se deri tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë marr parasysh natyrën e kësaj veprë penale, faktin duke marrë parasysh rrethanat personale që i njëjti rezulton të jetë i gjendjes së vështirë ekonomike, ka premtuar se nuk do të përsëris veprën penale si dhe moshën e re të tij çka për gjykatën rezulton se shumë më lehtë mund të bie nën ndikimin e rrethit shoqëror.

Gjykata, në kuptim të nenit 75 të KPRK-së, sa i përket dënimit me burg, ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore sipas nenit 75 par.1, nënpar.1.3 të KPRK-së, që e lejon gjykatën të shqiptoj dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë. Andaj, me rastin e aplikimit të zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë sipas nenit 76 par. 1, nënpar. 1.5 të KPRK-së.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg të kushtëzuar dhe dënimi me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit ndaj të pandehurit, ka shqiptuar edhe konfiskimin e substancës narkotike, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPP, ku përcakton se kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272 deri 280 të KPRK, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marr parasysh gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 269 i KPRK-së, i cili përcakton se subsantacat narkotike dhe substancat e tjera konfiskohe, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv, duke u bazuar në faktin se në aktakuzë nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-së nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.298/2021, datë 03.06.2021**  
**2019:153651, 03.06.2021**

Procesmbajtësja:  
Besarta Hajzeri

**Gjyqtari**

**Rrahman BEQIRI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.